



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 148/ Prot

Shkodër, më 16.01.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendim “Për miratimin e planit lokal të Rinisë 2026–2030, në bashkinë Shkodër”.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin “Për miratimin e planit lokal të Rinisë 2026–2030, në bashkinë Shkodër”.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

BENET BECI

**ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
ALBAN PREKA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1148 Prot

Shkodër, më 16.01.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____.2026

“PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË RINISË 2026-2030, NË BASHKINË SHKODËR”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; Ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, i ndryshuar, neni 7; Strategjive dhe planeve kombëtare sektoriale për mbrojtjen sociale, rininë, strehimin, barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale.

VENDOSI:

1. Të miratojë “Planin lokal të Rinisë 2026–2030, në bashkinë Shkodër” sipas materialit bashkëngjitur pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

ALBAN PREKA



Zv/Kryetar

Alban Preka

Drejtoria e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë

Edita Shashi

*Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore
dhe Shërbimeve Mbështetëse*

Drejtoria e Arsimit

Samir Kallaku

*Drejtoria e Shërbimeve Sociale,
Strehimit dhe Shëndetit Publik*

Artur Kruja

Drejtoria Juridike

Dr. Xhevdet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 1147 Prot

Shkodër, më 16/01 2026

RELACION “PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË RINISË 2026-2030, NË BASHKINË SHKODËR”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

I. QËLLIMI I VENDIMIT

Ky relacion paraqitet për miratimin nga Këshilli Bashkiak Shkodër të Planit Lokal të Rinisë 2026–2030, në bashkinë Shkodër, si dokument strategjik dhe operacional që udhëzon politikat vendore në fushën e rinisë, me synim fuqizimin e të rinjve, si aktorë kyç të zhvillimit lokal dhe ndërtimin e politikave rinore gjithëpërfshirëse, të bazuara në nevojat, potencialet dhe aspiratat e tyre.

II. BAZA LIGJORE

Plani Lokal i Rinisë 2026–2030 është hartuar dhe propozohet për miratim në mbështetje të kuadrit ligjor kombëtar në fuqi, konkretisht:

- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, 23, 24 dhe 25, që përcakton përgjegjësitë e bashkisë në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore, strehimit social, arsimit, kulturës dhe rinisë;
- Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”
- Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- Ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, i ndryshuar;
- Strategji dhe plane kombëtare sektoriale për mbrojtjen sociale, rininë, strehimin, barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale.

Ky plan është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër dhe strategjitë kombëtare përkatëse.

III. QËLLIMI I PLANIT DHE OBJEKTIVAT

Plani Lokal i Rinisë i Bashkisë Shkodër ka për qëllim fuqizimin e të rinjve si aktorë aktivë dhe partnerë kyç në zhvillimin social, ekonomik dhe qytetar të komunitetit. Plani synon të krijojë kushte që të rinjtë të jenë të përfshirë, të dëgjuar dhe të mbështetur në realizimin e potencialit të tyre, me fokus të veçantë tek të rinjtë në rrezik përjashtimi social.

Përmes forcimit të pjesëmarrjes rinore në proceset vendimmarrëse, nxitjes së punësimit, sipërmarrjes dhe inovacionit, si dhe investimeve në arsim joformal, vullnetarizëm, kulturë, sport dhe hapësira krijuese, plani synon të kontribuojë në ndërtimin e një brezi të aftë, të sigurt dhe të angazhuar. Në thelb, Plani Lokal i Rinisë e konsideron fuqizimin e të rinjve si një investim strategjik për të ardhmen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të Bashkisë Shkodër.

Ky plan parashikon:

- Zhvillimin dhe funksionimin e infrastrukturës rinore (qendra rinore, hapësira komunitare, platforma digjitale);
- Promovimin e arsimit joformal, formimit profesional, sipërmarrjes rinore dhe inovacionit social;
- Nxitjen e punësimit dhe vetëpunësimit të të rinjve, përmes bashkëpunimit me sektorin privat, institucionet e arsimit dhe strukturat e formimit profesional;
- Rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje, jetën publike dhe proceset konsultative në nivel vendor;
- Mbështetjen e të rinjve në rrezik social, përfshirë të rinjtë NEET, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe ata nga familje në vështirësi ekonomike.

Nëpërmjet kësaj shtylle synohet krijimi i një mjedisi mbështetës për zhvillimin personal, profesional dhe qytetar të të rinjve, si dhe parandalimi i migracionit dhe përjashtimit social.

Plani Lokal i Rinisë përmban objektivat si më poshtë:

- Përmirësimi i hapësirave të sigurta rinore që garantojnë zhvillimin e aktiviteteve të edukimit joformal
- Mbështetja dhe promovimi i kulturës, historisë dhe sportit tek të rinjtë

- Sigurimi i infrastrukturës cilësore brenda shkollave
- Mbështetja e zbatimit të Garancisë Rinore përmes parandalimit të braktisjes së shkollës
- Mbështetja e zbatimit të Garancisë për të Rinjtë, përmes krijimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave dhe programeve që promovojnë sipërmarrjen dhe inovacionin te të rinjtë
- Mbështetja e të rinjve për të ndjekur stile jetese të shëndetshme dhe të sigurt
- Forcimi i rolit të të rinjve në vendimmarrjen dhe përfaqësimin lokal
- Nxitja e dialogut të organizuar ndërmjet të rinjve dhe institucioneve publike në nivel bashkie
- Nxitja dhe përkrahja e grupeve dhe organizatave rinore në komunitet
- Mbështetja dhe promovimi i punonjësve rinorë dhe vullnetarëve

IV. SHTYLLAT E DOKUMENTIT

Plani Lokal i Rinisë 2026–2030 është strukturuar si më poshtë:

- A. Prioritetet e OZHQ-ve;
- B. Qëllimi;
- C. Metodologjia;
- D. Koncepti Logjik;
- E. Bashkërendimi;
- F. Parimet;
- G. Situata aktuale;
- H. Matrica;
- I. Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi

V. PËRFUNDIM

Miratimi i Planit Lokal të Rinisë 2026–2030 nga Këshilli Bashkiak Shkodër, përbën një hap strategjik dhe të rëndësishëm drejt fuqizimit të të rinjve si aktorë kyç të zhvillimit lokal, si dhe drejt ndërtimit dhe zbatimit të politikave rinore gjithëpërfshirëse, të bazuara në nevojat reale, potencialet dhe aspiratat e tyre.

Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër dëshmon angazhimin e saj për të forcuar politikat dhe programet që garantojnë pjesëmarrjen sociale, ekonomike dhe qytetare të të rinjve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të rinjve në rrezik përjashtimi social.

Për sa më sipër, propozohet për miratim nga Këshilli Bashkiak Shkodër Plani Lokal i Rinisë për periudhën 2026–2030.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

K R Y E T A R

BENET BECI

**ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
ALBAN PREKA**



Drejtorja e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë

Edita Shashi Shashi

Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik

Arturido Linge

PLANI LOKAL I VEPRIMIT

PËR RININË

2026-2030

BASHKIA SHKODËR

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes	1
Përmbledhje	2
Prioritetet e OZHQ-ve	2
Qëllimi	3
Metodologjia	4
Koncepti Logjik	6
Bashkërendimi	7
Kuari ligjor	7
Në nivel ndërkombëtar.....	9
Në nivel kombëtar	9
Në nivel vendor	11
Parimet.....	11
Qëndrueshmëria	11
Bashkërendimit.....	12
Transparenca	12
Gjithëpërfshirja.....	12
Fleksibiliteti	12
Situata aktuale	12
Profili i Bashkisë Shkodër.....	12
Përvoja e Bashkisë Shkodër në sektorin rinor	14
Analiza SWOT	18
Rinia dhe integrimi evropian.....	19
Matrica *	19
Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi	20

Përmbledhje

Bashkia Shkodër, në partneritet me Shoqatën “Gruaja tek Gruaja”, e mbështetur nga IAMANEH Switzerland dhe Europe Goes Local, ka hartuar Planin Lokal të Veprimit për Rininë, dokument i cili prezanton një përpjekje të strukturuar për transformimin e komunitetit në partneritet me të rinjtë.

Plani Vendor i Veprimit për Rininë në Bashkinë Shkodër është një dokument që përcakton qëllimet dhe strategjitë për të mbështetur dhe fuqizuar të rinjtë në nivel vendor. Ky plan veprimi synon të adresojë sfidat specifike të të rinjve në Bashkinë Shkodër, duke ofruar mjete dhe burime specifike për të arritur qëllimet e përcaktuara më poshtë.

Përmbajtja e një Plani Vendor të Veprimit për Rininë mund të ndryshojë në varësi të komunitetit, por në përgjithësi përfshin masa për të ofruar mundësi për arsimim, trajnim, angazhim në jetën kulturore dhe sportive, mbështetje për hyrjen në tregun e punës, si dhe sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm për të rinjtë.

Në rastin e Bashkisë Shkodër evidentohen nevoja të të rinjve për projektimin dhe rivitalizimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt edukativ, social, ekonomik, kulturor dhe politik, ku të rinjtë të gjejnë drejtësi sociale dhe të jenë proaktivë, duke qenë partnerë në konsolidimin e zhvillimit të së ardhmes së tyre dhe të komunitetit ku jetojnë.

Shtyllat mbi të cilat mbështetet kjo strategji janë në përputhshmëri me dokumentet strategjike për çështjet që prekin rininë në mënyrë direkte dhe indirekte, në nivel vendor dhe qendror, me “Strategjinë Evropiane për të Rinjtë 2019–2027”, si dhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Po aq të rëndësishme janë edhe analizat në nivel vendor, përfshirë analizën SWOT të fushave që janë në kompetencë të bashkisë. Si rezultat i analizës dhe i të gjitha informacioneve të mbledhura, përcaktohen qëllimi, objektivat dhe aktivitetet që do të trajtohen më poshtë.

Prioritetet e OZHQ-ve

Janë 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilët janë të gjithë të rëndësishëm dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Disa prej tyre do të jenë më të rëndësishëm në Planin e Veprimit për Rininë në Bashkinë Shkodër.

Ky seksion prezanton objektivat që janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Planit të Veprimit për Rininë në Bashkinë Shkodër.

Objektivi 4 i Zhvillimit të Qëndrueshëm për rininë në Bashkinë Shkodër synon zhvillimin e një arsimit cilësor dhe të barabartë për të gjithë të rinjtë në Bashkinë Shkodër, duke adresuar padrejtësitë në arsim. Ky objektiv kërkon bashkëpunim me qeverinë lokale, institucionet arsimore dhe organizatat e interesuara në fushën e arsimit për të përmirësuar infrastrukturën arsimore dhe për të zhvilluar programe të arsimit cilësor.

Objektivi 5 i Zhvillimit të Qëndrueshëm për rininë në Bashkinë Shkodër synon promovimin e drejtësisë dhe barazisë gjinore për të rinjtë në këtë zonë, duke adresuar diskriminimin gjinor dhe duke ndihmuar në zhvillimin e programeve të arsimit cilësor. Ky objektiv kërkon bashkëpunim me organizatat e të rinjve dhe institucionet arsimore.

Objektivi 13 i Zhvillimit të Qëndrueshëm për rininë në Bashkinë Shkodër synon të ndihmojë të rinjtë në zhvillimin e njohurive dhe kapaciteteve për ndryshimet klimatike dhe të promovojë praktika të qëndrueshme. Ky objektiv do të zhvillohet nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e të rinjve, qeverinë lokale dhe institucionet arsimore.

Objektivi 16 i Zhvillimit të Qëndrueshëm për rininë në Bashkinë Shkodër synon zhvillimin e një qeverisjeje të qëndrueshme dhe të drejtë për të rinjtë, përmes bashkëpunimit ndërmjet qeverisë lokale, organizatave të të rinjve dhe institucioneve arsimore. Kjo do të ndihmojë në dhënien e një roli aktiv të të rinjve në qeverisjen e tyre.

Qëllimi

Ky instrument është hartuar në përputhje me kornizën ligjore dhe synon të zbatojë detyrat që ajo përcakton, nën udhëheqjen e parimit të transparencës.

Zhvillimi i qëndrueshëm në njësitë e qeverisjes në Republikën e Shqipërisë po orienton të gjitha politikat, si në nivel vendor ashtu edhe në nivel qendror, duke u bazuar në parimet kushtetuese dhe në procesin e decentralizimit, në mbështetje të autonomisë së njësive të qeverisjes vendore për realizimin e kompetencave të përcaktuara nga kuadri ligjor.

Ky instrument është në përputhje me kuadrin ligjor dhe synon të implementojë detyrat që ai përcakton, duke shërbyer si një mjet që ndihmon Bashkinë në zhvillimin strategjik të rinisë. Mbi të gjitha, ai ka për qëllim kryesor të jetë një dokument strategjik që nxit zhvillimin e rinisë, duke respektuar rendin kushtetues të Republikës së Shqipërisë dhe ligjet e saj, si dhe duke promovuar një rini të angazhuar aktivisht në gjenerimin e kulturës, proaktive në përmirësimin e mirëqenies

sociale dhe ekonomike, dhe që vepron si partnere dhe avokuese e komunitetit dhe e institucioneve për sfidat dhe problematikat me të cilat përballet. E gjithë kjo bëhet me synimin e arritjes së standardeve dhe anëtarësimit në familjen e madhe të Bashkimit Evropian.

Angazhimi civil, përmirësimi ekonomik i shoqërisë, mbrojtja dhe siguria sociale, si dhe nxitja e sipërmarrjes inovative tek të rinjtë e Bashkisë Shkodër janë disa nga elementët e vizionit evropian me të cilin ata identifikohen.

Dialogu i strukturuar dhe angazhimi i tillë synojnë jo vetëm përdorimin efektiv të burimeve që gjenden në komunitet, por mbi të gjitha bashkërenditjen e aktiviteteve, projekteve dhe burimeve në të gjitha nivelet komunitare dhe qeverisëse, në shërbim të zbatimit të vizionit të përbashkët. Konsolidimi i bashkëpunimit ndërmjet komunitetit të biznesit, shoqërisë civile, organizatave vendore, kombëtare e ndërkombëtare, si dhe qeverisjes vendore dhe qendrore, është çelësi kyç.

Metodologjia

Plani Vendor i Veprimit për Rininë është një mjet thelbësor për të vlerësuar nevojat, për të planifikuar aktivitetet, për të zbatuar dhe monitoruar vazhdimisht shërbimet për rininë, si dhe për të hartuar politikat vendore të rinisë dhe për të planifikuar projektet rinore.

Plani Vendor i Veprimit për Rininë përfaqëson një mjet kryesor, i cili është krijuar duke u bazuar në një metodologji gjithëpërfshirëse, përmes së cilës Bashkia Vau i Dejës, në bashkëpunim me të gjitha institucionet publike, individët, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat, zhvillon ndërhyrje të integruara në shërbimet për rininë.

Metodologjia për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Rininë në Bashkinë Shkodër përfshin hapat e mëposhtëm:

1. Analiza e situatës së tanishme – për rininë në Bashkinë Shkodër është hapi i parë në hartimin e planit vendor të veprimit. Ky hap përfshin mbledhjen e informacioneve në lidhje me rininë, sfidat dhe mundësitë që ajo has, si dhe njohjen e aktiviteteve dhe programeve të disponueshme për ta në dokumentet strategjike në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni i mbledhur ka ndihmuar në përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave të planit, si dhe në zhvillimin e një strategjie efektive për adresimin e sfidave të të rinjve. Kjo analizë është bazuar në sondazhe dhe intervista paraprake me të rinjtë, të realizuara në kuadër të këtij projekti, si dhe në hulumtime të tjera relevante, si konsultimi i dokumenteve strategjike në nivel vendor dhe kombëtar.

2. Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave të planit – ky hap është i rëndësishëm, pasi qëllimet dhe objektivat e planit do të shërbejnë si udhërrëfyes për aktivitetet dhe projektet e zhvilluara në të ardhmen. Në këtë fazë, bazuar në analizën paraprake, janë përcaktuar qëllimet e planit, të cilat janë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë (SMART). Qëllimet përmbledhin sfidat dhe nevojat e identifikuara në fazën e parë të analizës së situatës. Pas përcaktimit të qëllimeve, janë përcaktuar edhe objektivat, të cilat përfaqësojnë hapa konkretë

drejt arritjes së qëllimeve të planit. Objektivat janë të ndërlidhura me qëllimet e planit dhe japin një ide të qartë se si do të adresohen sfidat dhe nevojat e rinisë në Bashkinë Shkodër.

3. Identifikimi i aktiviteteve – ky hap nënvizon mënyrat dhe metodat që do të përdoren për të arritur qëllimet dhe objektivat e planit. Në këtë fazë janë përcaktuar aktivitetet dhe projektet e nevojshme për arritjen e objektivave, si dhe burimet e nevojshme për realizimin e tyre. Në zhvillimin e strategjisë janë marrë në konsideratë faktorë të ndryshëm, si infrastruktura dhe burimet në dispozicion, kapacitetet ekzistuese dhe ndikimi i faktorëve të jashtëm, si rregulloret dhe legjislacioni në fuqi.

4. Përzgjedhja e burimeve dhe mjeteve – janë kryer hulumtime për të identifikuar burimet financiare, njerëzore dhe teknologjike që janë në dispozicion në Bashkinë Shkodër. Për të siguruar që aktivitetet e përcaktuara në fazën e mëparshme të jenë të zbatueshme dhe efektive, janë identifikuar burimet e nevojshme financiare, njerëzore dhe teknologjike. Kjo ka përfshirë identifikimin e fondacioneve, organizatave, institucioneve publike vendore dhe qendrore, etj., të cilat mund të ofrojnë mbështetje financiare ose burime të tjera për realizimin e planit.

Gjithashtu, është realizuar një vlerësim i kostos së zbatimit të planit dhe janë përcaktuar burimet financiare të nevojshme për mbulimin e saj. Kjo siguron që plani të jetë i zbatueshëm financiarisht dhe që burimet e nevojshme të jenë në dispozicion për realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

5. Hartimi i Planit të Veprimit për Rininë – është një proces kreativ dhe dinamik që ndihmon në përcaktimin e qëllimeve të projektit dhe në identifikimin e aktiviteteve që kontribuojnë në arritjen e tyre. Për hartimin e këtij plani janë ndërmarrë hapa të tillë si hulumtimi, përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave, identifikimi i aktiviteteve, përzgjedhja e burimeve dhe mjeteve, etj. Gjithashtu, janë përcaktuar kohëzgjatja e aktiviteteve, burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme, si dhe masat për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit. Planin e veprimit është i qartë dhe i strukturuar në mënyrë që të jetë i lehtë për t'u ndjekur dhe i besueshëm për të gjitha palët e interesuara. Ai është gjithashtu dinamik dhe fleksibël, në mënyrë që të përshtatet me ndryshimet që mund të ndodhin gjatë zbatimit të tij.

6. Implementimi dhe monitorimi i Planit të Veprimit – ky është një hap i rëndësishëm në realizimin e projekteve për rininë. Ai përfshin zbatimin e aktiviteteve të identifikuar dhe monitorimin e efektivitetit të tyre në komunitet. Në këtë fazë është e rëndësishme të ndërmerren masa për të siguruar koordinimin dhe harmonizimin e aktiviteteve ndërmjet tyre, si dhe disponueshmërinë e burimeve financiare, njerëzore dhe teknologjike.


Monitorimi përfshin vlerësimin e progresit, identifikimin e sfidave apo problemeve që mund të shfaqen gjatë zbatimit të planit dhe marrjen e masave korrigjuese. Nëse shfaqet nevoja, mund të bëhen ndryshime në planin e veprimit për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara, si pasojë e sfidave të paparashikuara apo ndryshimeve në mjedisin dhe nevojat e komunitetit.

7. Vlerësimi dhe raportimi – në këtë hap vlerësohet efektiviteti i planit të veprimit dhe identifikohen aktivitetet që kanë funksionuar më mirë, si dhe ato që kanë nevojë për përmirësim.

Vlerësimi mund të realizohet përmes mjeteve të ndryshme, si pyetësorë për qytetarët, anketa me të rinjtë, studime të efektivitetit të aktiviteteve, etj.

Në përfundim, hartohet një raport i detajuar që pasqyron rezultatet e arritura nga zbatimi i planit të veprimit. Nëse është e nevojshme, raporti shërben edhe për rishikimin dhe përmirësimin e planit, me qëllim rritjen e efektivitetit të tij në të ardhmen. Këto raporte janë të rëndësishme për të paraqitur progresin e arritur dhe për të mbështetur vendimmarrjen në projektet e ardhshme në fushën e rinisë.

Koncepti Logjik



Bashkërendimi

Bashkërendimi i Planit të Veprimit për Rininë me dokumentet strategjike në nivel vendor, qendror dhe ndërkombëtar, si dhe me kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë, është një proces i rëndësishëm koordinimi ndërmjet Bashkisë Shkodër, qeverisë, organizatave ndërkombëtare, kombëtare e vendore dhe të rinjve.

Ky proces siguron që objektivat e të rinjve të jenë në përputhje me ato të qeverisë, duke krijuar një sinergji të fortë ndërmjet palëve dhe duke i dhënë rinisë rëndësinë e një partneri strategjik për zhvillimin e komunitetit. Përveç kësaj, bashkërendimi i Planit të Veprimit me dokumentet strategjike në të gjitha nivelet siguron që fondet e disponueshme të përdoren në mënyrë efektive për të ndihmuar në arritjen e objektivave të rinisë.

Bashkërendimi i Planit të Veprimit me dokumentet strategjike siguron gjithashtu qëndrueshmërinë e politikave dhe programeve për rininë në të ardhmen. Ky proces krijon një kornizë afatgjatë që ndihmon në arritjen e objektivave të të rinjve. Në mënyrë të ngjashme, bashkërendimi i Planit të Veprimit me dokumentet strategjike ndihmon në zhvillimin e mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies për të vlerësuar progresin dhe për të ndërhyrë, nëse është e nevojshme.

Në përmbyllje, bashkërendimi i Planit të Veprimit për Rininë me dokumentet strategjike në nivel vendor, qendror dhe ndërkombëtar përbën një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të një politike efektive për rininë, me synim përvetësimin e vlerave evropiane dhe përafrimin me strategjitë e Bashkimit Evropian. Ky proces kontribuon në mbështetjen e nevojave të të rinjve, në arritjen e objektivave të përbashkëta dhe në ndërtimin e një të ardhmeje sa më të qëndrueshme.

Kuadri ligjor

Kushtetuta – Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon mbrojtje të veçantë për të rinjtë: “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti”. Të drejtat e të rinjve garantojnë në kuadrin e të drejtave dhe lirive të njeriut që parashikon ky dokument themeltar i shtetit shqiptar.

Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë”; Ligji nr. 24/2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2019 ‘Për Rininë’” specifikon se të rinjtë janë personat nga 15 deri në 29 vjeç. Ligji përcakton aktivitetet, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Shqipëri dhe në diasporë, si dhe rrit pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes, si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor. Ligji u miratua për të mbrojtur të drejtat e të rinjve dhe për të krijuar kushte për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e tyre.

Ky ligj prezanton disa koncepte të rëndësishme, si:

- Edukimi joformal për të rinjtë, që lidhet me veprimtaritë jashtë sistemit të arsimit formal dhe bazohet në vullnetarizëm dhe pjesëmarrje aktive;
- Grupi joformal rinor është grupimi i të rinjve që ndajnë qëllime dhe vlera të përbashkëta, i cili nuk është regjistruar si person juridik në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfaqësohet nga anëtarët e tij dhe vepron me qëllim mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve dhe zhvillimin e komunitetit vendor;
- Dialogu i strukturuar mes të rinjve, organizatave të tyre, organizatave që punojnë me ta dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, duke theksuar bashkëpunimin e bazuar në ndërveprim aktiv, sistematik, transparent, të vazhdueshëm dhe afatgjatë;
- Qendra rinore është personi juridik që ofron infrastrukturën rinore për zhvillimin, nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, grupet joformale rinore dhe vetë të rinjtë, të aktiviteteve dhe veprimtarive rinore, programeve të edukimit joformal, aktiviteteve të informimit, mentorimit dhe trajnimit të të rinjve, si dhe të punës rinore;
- Hapësirat e sigurta rinore përkufizohen vetëm si hapësira fizike të sigurta për të rinjtë, përfshirë të rinjtë me aftësi të kufizuara, pa përfshirë elementet digjitale apo platformat sociale dhe qytetare të hapësirave të sigurta për të rinjtë.

Ligji e përkufizon “punën rinore” si “çdo veprimtari e natyrës sociale, kulturore, arsimore ose mjedisore, nga, me ose për të rinjtë, në grupe ose individualisht, që ka për qëllim të motivojë dhe të mbështesë të rinjtë, duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social, si dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi”, por nuk përcakton kriteret për “punonjës in rinor” apo “drejtues in rinor”.

Ligji parashtroi krijimin e një baze ligjore për dy struktura konsultative rinore, përfshirë Këshillin Vendor të Rinisë (KVR), i cili duhet të ngrihet dhe të fuqizohet nga pushteti vendor.

Gjithashtu, ligji parashikon sigurimin e burimeve të financimit për politikën, programet dhe aktivitetet rinore, duke theksuar kontributin e buxheteve vendore në këtë drejtim, krahas buxhetit të shtetit. Njëkohësisht, ai parashikon edhe burime të tjera të ligjshme financimi, si të ardhurat e krijuara nga aktivitetet e organizatave rinore, donacionet, sponsorizimet, programet evropiane, etj.

Në nivel ndërkombëtar

Strategjia Evropiane e Rinisë bazohet në 11 qëllime, të cilat janë jetësuar edhe në strategjinë kombëtare të Shqipërisë: 1. Lidhja e BE-së me rininë 2. Barazia mes të gjitha gjinive 3. Shoqëria gjithëpërfshirëse 4. Dialog konstruktiv dhe shpërndarje informacionesh 5. Shëndeti mendor dhe mirëqenia 6. Nxitje dhe përparësi për rininë rurale 7. Punësim cilësor për të gjithë 8. Të mësuarit cilësor 9. Hapësirë dhe pjesëmarrje për të gjithë 10. Evropa e gjelbër dhe e qëndrueshme 11. Organizatat rinore dhe programe rinore evropiane. Në strategjinë evropiane të rinisë, fushat kyçe të sektorit rinor shprehen me tri folje: Angazhohu, Lidhu dhe Fuqizohu.

Strategjia e OKB-së për rininë 2030 mbështetet në vizionin global të një bote ku të drejtat njerëzore të çdo të reje dhe të riu bëhen realitet; ku sigurohet se çdo e re apo i ri fuqizohet për të arritur potencialin e vet të plotë; dhe që e njeh kapacitetin, qëndrueshmërinë dhe kontributet pozitive të të rinjve si agjentë të ndryshimit.

Agjenda e Ballkanit Perëndimor për novacionin, kërkimin shkencor, arsimin, kulturën, rininë dhe sportet paraqet një strategji dhe kornizë afatgjatë të bashkëpunimit ekonomik, duke dhënë njëkohësisht një vizion pozitiv dhe largpamës, në veçanti për rininë.

Karta Evropiane e punës me të rinjtë në nivel lokal, qëllimi i kartës kontribuon në zhvillimin e mëtejshëm të punës me të rinjtë në nivel lokal. Këtë e realizon duke theksuar se cilat janë parimet që duhet ta drejtojnë atë dhe si duhen hartuar aspekte të ndryshme të tyre, në mënyrë që të përmbushen këto parime. Prandaj, karta përbën një platformë të përbashkët evropiane për dialogun e nevojshëm për punën me të rinjtë.

Në nivel kombëtar

Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029 është dokumenti ku do të bazohen politikën për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë dhe që lidhen me sfida si përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse,

punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zëjet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm etj.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2022–2024 – ky plan e vendos si prioritet të tij rininë, si grup i caktuar shoqëror me interesa dhe nevoja të veçanta, trajtohet në kapitullin 26 (fq. 400), kapitull i cili në tërësinë e vet përfshin çështje të rëndësishme për rininë, siç janë arsimi dhe kultura.

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (PKVR) – Qëllimi i këtij plani është zhvillimi dhe koordinimi i politikave ndërsektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 – Përveç rritjes së cilësisë dhe ofertës së arsimit e formimit profesional, hapen një sërë programesh që mbështesin dhe nxisin punësimin e të rinjve.

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 – i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të plotë të të rinjve, si brenda ashtu edhe jashtë shkollës, duke krijuar mundësi për zhvillimin digjital në arsim dhe revolucionarizimin e orës mësimore, por dhe duke ndërtuar masa specifike për aktivitete pas mësimin.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020–2023 – synon që të luftojë pabarazitë socio-ekonomike, parashikon një sistem që ka politikën dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë ose të përjashtuar, nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegritit social, alternuar me skemat e punësimit.

Plani Kombëtar për persona me aftësi të kufizuara 2021–2025 – ka për qëllim të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbime publike.

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptjanëve – ka për synim heqjen e pengesave me të cilat përballen romët dhe egjiptianët sa i përket aksesit në shërbime dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës, nëpërmjet integritit dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor.

Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+ 2021–2027 – synon të sigurojë një shoqëri gjithëpërfshirëse, jo-diskriminuese dhe të sigurt për personat LGBTI në Shqipëri.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 – është konceptuar si një udhërrëfyes drejt një shoqërie të mundësive të barabarta dhe pa dhunë, në të cilën nevojat e grave dhe burrave merren në konsideratë dhe trajtohen në mënyrë të barabartë; gratë respektohen, mbrohen, nxiten dhe mbështeten për të ecur përpara njëloj si dhe burrat, vajzat dhe djemtë rriten të lumtur mes parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit.

Në nivel vendor

Strategjia Territoriale 2015 – 2030 e Bashkisë Shkodër formon dokumentin bazë të zhvillimit të territorit, në të cilën citohet se “Bashkia Shkodër në 2030 do të jetë një qendër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Bashkia Shkodër është lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajoneve natyrore, ndërkufitare e turistike. Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar 5 objektiva strategjike, 5 objektiva strategjike, 28 programe strategjike, 198 projekte të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme.

Këshilli Vendor Rinor i Bashkisë Shkodër i ngritur me VKB nr 19, datë 20/07/2023, përcakton politikën për të rinjtë si një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë.

Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2020-2023, synon hartimin e një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të nxisë zhvillimin e një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Në veçanti pjesëmarrja e rinisë në jetën publike dhe forcimi i statusit socio-ekonomik të saj përbëjnë një domosdoshmëri për arritjen e standardeve evropiane dhe një ekonomie tregu të aftë për t’u përballur me sfidat e globalizimit.

Plani vendor i veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2023 -2025 është hartuar bazuar në nevojat që autoritetet vendore kanë, lidhur me ndryshimet e fundit që pësoi ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Ky plan ofron informacione lidhur me diasporën dhe migracionin dhe nënvizon sfidat dhe mundësitë e pjesëmarrjes më gjithëpërfshirëse të diasporës në përmirësimin dhe zhvillimin e gjendjes ekonomike në vend.

Plani Social i Zonës 2018 - 2021 - Plani Social i Bashkisë Shkodër ka përcaktuar objektivat dhe prioritetet strategjike katër vjeçare 2018-2021 sigurojë dhe ofrojë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Ky plan social udhëheq zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror të bashkisë Shkodër duke ndërtuar mbi eksperiencën dhe tëresinë e shërbimeve ekzistuese dhe duke i pasuruar ato me shërbime të reja të domosdoshme për territorin e mbuluar. Në këtë plan rinia ka pasur një rol themelor.

Parimet

Qëndrueshmëria

Parim i cili udhëheq hartimin e të gjitha planeve në nivel kombëtar dhe vendor. Ky parim monitoron, vlerëson dhe projekton veprimtaritë e propozuara me qëllim t’i ofrojë rinisë zhvillim dhe angazhim të vazhdueshëm dhe gjithnjë e më cilësor.

Bashkërendimit

Ky plan është hartuar duke qenë në koordinim me kuadrin strategjik të zhvillimit të Bashkisë Shkodër, në përputhshmëri me objektivat dhe veprimtaritë kryesore tashmë të përcaktuara nga ato, si dhe në harmoni me aktivitetet e propozuara nga rinia ndër vite.

Transparenca

Veprimtaritë e propozuara në këtë plan gjejnë thjeshtësinë e monitorimit dhe nxisin transparencën për faktin që janë të matshme nëpërmjet treguesve të performancës.

Gjithëpërfshirja

Ky plan, përveç përvetësimit të gjithëpërfshirjes në thelbin e tij, duke filluar nga vizioni i gjerë tek veprimtaritë specifike, promovon një vëmendje më të lartë ndaj grupeve të marginalizuara me aktivitetet e tij.

Fleksibiliteti

Ky plan merr parasysh dinamikën e reformave, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë lokal, të cilat mund të prekin funksionet dhe kompetencat e tyre. Marrë parasysh kjo, ky plan gjendet në implementim dhe përshtatet me çdo lloj konteksti social dhe politik.

Situata aktuale

Profili i Bashkisë Shkodër

Shkodrës, duke mbuluar një sipërfaqe prej 872.71 km² dhe duke përbërë një qendër urbane dhe nëntëdhjetë e dy fshatra. Administrativisht, ajo përfshin njëmbëdhjetë njësi: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postrinë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Me 212,467 banorë të regjistruar zyrtarisht, bashkia përbën afërsisht 62% të popullsisë së rajonit. Struktura demografike karakterizohet nga një përqendrim i lartë në qytetin e Shkodrës, ku banon rreth 55% e popullsisë së përgjithshme (116,285 banorë), ndërsa njësia më e madhe administrative rurale, Rrethina, numëron 28,894 banorë.

Referuar të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, gjatë vitit shkollor 2022–2023, 12,230 fëmijë ndoqën 86 shkolla publike në të gjithë qytetin dhe njësitë administrative. Nga këto, 26 shkolla funksionojnë si qendra komunitare, duke i zgjeruar mjediset e tyre në aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative. Ekzistojnë tetë shkolla të mesme të përgjithshme – pesë të vendosura në qytet dhe tre në njësitë administrative – të cilat ndiqen nga 2,246 nxënës, ndërsa tre shkolla profesionale regjistruan gjithsej 1,264 nxënës (700 në shkollën “Hamdi Bushati”, 100 në shkollën “Kolë Margjini” dhe 464 në shkollën “Arben Broci”).

Nga këndvështrimi strukturor demografik, në Bashkinë Shkodër banojnë rreth 62% e popullsisë së qarkut Shkodër. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 212,467 banorë. Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës, me 55% të popullsisë (116,285 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsinë më të madhe është ajo e Rrethinave me 28,894 banorë.

Referuar të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për vitin 2022 rezulton se të rinjtë dhe të rejat në Bashkinë Shkodër për grupmoshën 15–29 vjeç janë 44,889, nga të cilat grupmosha 19–24 vjeç është më e shumtë në numër me 17,614 të rinj, e ndjekur nga 17,085 të rinj të moshës 25–29 vjeç dhe 10,190 të rinj të moshës 15–18 vjeç. Ndërsa raporti gjinor është relativisht i ekuilibruar në Bashkinë Shkodër, me 21,530 të reja dhe 23,359 të rinj.

Në përputhje me parimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e kompetencave dhe të funksioneve të ndryshme sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për të cilat detyrimi dhe përgjegjësia për trajtimin me prioritet të rinisë shprehet qartësisht në nenet 22–30 që evidentojnë parimet për ushtrimin e funksioneve në fushat e infrastrukturës, shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit, shërbimeve argëtuese, si dhe në një sërë fushash të tjera, Bashkia Shkodër është një nga njësitë e vetëqeverisjes vendore që nuk ka humbur kohë për hedhjen e hapave konkretë në këtë drejtim.

Aktiviteti i Bashkisë Shkodër drejt fuqizimit të të rinjve nis me ndërtimin e qendrës së parë rinore publike me emrin “Atelie”, e cila është shërbim publik i Bashkisë Shkodër dedikuar rinisë dhe synon fuqizimin dhe nxitjen e rinisë nëpërmjet zbatimit të programeve të edukimit, punësimit dhe sipërmarrjes, të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit rinor në politikë, të artit, kulturës, sportit, nxitjes së nismave dhe organizimit rinor, si dhe programeve të çështjeve sociale dhe shëndetësore.

Arsimi është një tjetër fushë e rëndësishme për Bashkinë Shkodër, pasi është burimi më i rëndësishëm ku të rinjtë mund të zhvillojnë aftësitë e tyre në fusha dhe profesione të ndryshme, si hoteleri-turizëm, teknologji dhe informacion, artet, kultura, sporti etj.

Aktualisht, në qytetin e Shkodrës dhe në njësitë administrative numri i shkollave publike është 86 gjithsej (shkolla 9-vjeçare dhe të mesme), të cilat për vitin shkollor 2022–2023 kanë frekuentuar gjithsej 12,230 fëmijë.

Në qytetin e Shkodrës janë 26 shkolla qendra komunitare (shkolla 9-vjeçare dhe të mesme).

Shkolla të mesme të përgjithshme në qytetin e Shkodrës janë 8 gjithsej, në të cilat për vitin shkollor 2022–2023 kanë frekuentuar 2,246 të rinj (5 shkolla të mesme në qytet dhe 3 shkolla të mesme në njësitë administrative).

Shkolla të mesme profesionale janë gjithsej 3, në të cilat për vitin shkollor 2022–2023 kanë frekuentuar në total 1,264 të rinj (700 nxënës në shkollën “Hamdi Bushati”, 100 nxënës në shkollën teknologjike pyjore “Kolë Margjini” dhe 464 nxënës në shkollën e mesme profesionale “Arben Broci”).

Të rinjtë vuajnë pasojat e papunësisë për një sërë arsyesh, nga të cilat mungesa e orientimit dhe këshillimit profesional, apo hartimi i planeve individuale për drejtimin në karrierë është një ndër to. Të rinjtë kanë nevojë për një vend ndërveprues ku të ndihen të përfshirë në komunitet, që ofron mundësi të reja arsimore formale dhe joformale, kulturore, mbështet zhvillimin e tyre social-ekonomik nëpërmjet programeve të punësimit, këshillave të orientuara për karrierë, bashkëpunimit ndër-institucional, ku nën drejtimin e Bashkisë mund të krijohen kushte që favorizojnë hapjen e kurseve informative dhe formative për brezat e rinj, në mënyrë që të kenë mundësinë të familjarizohen me artin dhe muzikën.

Përvoja e Bashkisë Shkodër në sektorin rinor

Bashkia e Shkodrës ka një strukturë të përzier që kontribuon për të rinjtë. Në këtë fushë funksionojnë dy drejtorë: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, e cila mbështet dhe ka në strukturën e saj të brendshme Qendrën Rinore Publike “Atelie”, dhe Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, e cila përfshin rininë në aktivitete kryesisht të kulturës dhe sportit.

Bashkia e Shkodrës, në vitin 2016, me krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, me vizionin “Shërbime sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standardizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qelizë bazë e shoqërisë”, njëkohësisht ka filluar punën për ngritjen e shërbimit social në komunitet; një shërbim i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm jo vetëm për shtrirjen gjeografike të territorit të Bashkisë Shkodër pas reformës territoriale, por edhe me synimin e ofrimit të shërbimit social sa më pranë komunitetit dhe të rinjve.

Kështu filloi krijimi i rrjetit të shërbimeve sociale në komunitet me Qendrat Komunitare “Për Familjen”, të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Këto qendra ofrojnë shërbime parashoqërore si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale etj.; ofrojnë shërbime komunitare si mbrojtja e fëmijëve, fuqizim ekonomik për familjen, programe për prindërimin pozitiv, klasa pas-shkollore, shërbime për kujdesin shëndetësor etj. Të gjitha shërbimet e lartpërmendura ofrohen për kategoritë vulnerable: fëmijë, të rinj, persona me aftësi të kufizuara, rom dhe egjiptian, të moshuar etj.

Bashkia e Shkodrës, në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale në territor, ka arritur sigurimin e financimit dhe krijimin e Qendrës së parë Rinore Publike në territorin e bashkisë. Qendra Rinore “Atelie” i dedikohet përfshirjes edukative, artistike, sociale dhe kulturore të të rinjve, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe aksesin në sipërmarrje, kulturë, art, teknologji dhe informacion.

Objektivi kryesor i qendrës rinore mbështetet në fuqizimin dhe promovimin e të rinjve përmes zbatimit të programeve arsimore cilësore dhe gjithëpërfshirëse, punësimit dhe sipërmarrjes, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në politikë dhe vendimmarrje (vendore dhe qendrore), art, kulturë, sport dhe mjedis; promovimin e nismave dhe organizatave dhe programeve rinore për çështje sociale dhe shëndetësore; të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në promovimin e të rinjve të rajonit tonë.

Në këtë drejtim, Bashkia Shkodër, me anë të buxhetit të saj, kontribuon në lehtësimin e infrastrukturës dhe mbulon koston e personelit, kostot operative dhe shpenzimet e mirëmbajtjes së hapësirave të dedikuara. Nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile, aktivitetet realizohen me kapacitetin maksimal që ofron qendra rinore e qytetit.

Qendra Publike Rinore ka një bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera vendore si “Qendra e Formimit Profesional”, “Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër” dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive “AKPA”, të cilat janë gjithmonë të ftuara dhe të lira për të përdorur hapësirat e qendrës, për të zhvilluar trajnimet e tyre, sesionet informuese dhe për të përfshirë të rinjtë në programet e tyre të punësimit.

Bashkia Shkodër po punon në vazhdimësi me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka partneritet me institucione të ndryshme për krijimin e marrëdhënieve, bashkëpunimit dhe financimit në fushën e rinisë. Disa nga organizatat me të cilat bashkia ka marrëveshje partneriteti, të cilat zbatohen në funksion të Qendrës Rinore “Atelie” dhe janë të lokalizuara brenda qendrës duke i dhënë asaj aktivitete të përditshme, janë:

- “YEA! – Young Entrepreneurs Albania” – një organizatë e fokusuar në mbështetjen e sipërmarrësve të rinj në Shqipëri, duke krijuar aktualisht inkubatorin e biznesit në hapësirat e qendrës rinore, zhvillon orët periodike pas-shkollore, ndihmon familjet në nevojë me pagesa mujore dhe ofron konkurse periodike për të rinjtë me synimin për të fituar aftësi menaxheriale për bizneset e ardhshme;
- “UNICEF” – një agjenci e Kombeve të Bashkuara përgjegjëse për ofrimin e ndihmës humanitare dhe zhvillimore për fëmijët në mbarë botën, ka ndërtuar në qendrën rinore një laborator të ri TIK të quajtur “BIBLIOTECH”, një mundësi e shkëlqyer për të rinjtë që të punojnë pa pagesë në internet, promovon internetin e sigurt dhe inovacionin në mënyrën se si studiojnë të rinjtë;
- “Save the Children” – një organizatë lider humanitare për fëmijët, e cila ofron mbështetje për të rinjtë në aspektin e aftësive të buta, orientimit dhe këshillimit, ofron kurse pas-shkollore deri në moshën 24 vjeç dhe klasa artizanale (hapësira të dhëna në përdorim nga qendra rinore).

Bashkia Shkodër ka ngritur qendrën multifunktionale "Xixëllonjat", e cila mundëson ofrimin e shërbimeve bazë, të munguara dhe shumë të rëndësishme për të rinjtë dhe komunitetin e lagjes tradicionale, por edhe për banorët e zonës informale të krijuar pas viteve '90 në breg të liqenit.

Bashkia Shkodër zhvillon aktivitete të brendshme për promovimin e identitetit dhe vlerave lokale dhe kombëtare dhe gjithashtu nxit, mbështet dhe financon aktivitetet kulturore, sportive dhe argëtuese për të rinjtë. Gjithashtu, ka përmirësuar nxitjen dhe krijimin e programeve të shkëmbimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Disa nga institucionet e tjera vendore që bashkia bashkëpunon në fushën e rinisë janë Teatri i qytetit "Migjeni", trupa e së cilës prej 10 të rinjsh u krijua fillimisht nga Grupi i Aktrimit i Qendrës Rinore "Atelie"; Qendra Kulturore "Pjeter Gaci", e cila kohë pas kohe shfrytëzon sallën e vallëzimit për provat e tyre; Biblioteka e qytetit "Marin Barleti", me të cilën aktualisht po punojnë për krijimin e Grupit të Leximit; Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive "AKPA" dhe Qendra e Formimit Profesional.

Nismat e ndërmarra në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuessve kanë për qëllim promovimin e forcës aktive të punës dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Për herë të parë në vendin tonë u krijua platforma e përbashkët "Tregu i Punës Shkodër", me financim të qeverisë austriake (projekti Seed), një instrument i cili sjell sëbashku një numër të gjerë aktorësh përgjegjës për çështjet e punësimit, duke ofruar mbështetje në drejtim të aksesit në shërbimet e punësimit dhe edukimit, si dhe bashkëpunimit ndërinstitutional.

Panairi i Punës dhe Biznesit, i cili përveç partnerëve të përhershëm vendorë – Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër, Qendra e Formimit Profesional, Universiteti "Luigj Gurakuqi", shkollat profesionale (Shejnaze Juka, Hamdi Bushati, Shkolla Kolë Margjini, Shkolla Peter Mahringer, Shkolla Arben Broci), QAFS Maria Ndihmëtaria, kurse profesionale private "Arti i Guzhinës" – këtë vit gjeti mbështetjen e donatorëve të huaj.

Bashkëpunimi me bizneset prodhuese dhe promovimi i produkteve të tyre. Në këtë drejtim, me shumë interes ishte realizimi i botimeve dhe materialeve promocionale në mbështetje të investitorëve dhe bizneseve të territorit të bashkisë si: Profili i Bashkisë, Profili i Bizneseve, Investo në Shkodër, publikimi i katalogut të produkteve të territorit të Bashkisë Shkodër, publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe të huaja).

Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative. Me qëllim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, do të organizohet panairi i produkteve agropërpunuese. Në këtë panair prezantohen të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional; secila do të ndërtojë stendën e saj. Ky manifestim është i tipit të hapur për pjesëmarrësit.

Panairi i promovimit të vlerave artistike–kulturore dhe i produkteve të territorit (për njësitë administrative). Bashkia është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet natyrore të saj. Në këtë kuadër, është parashikuar organizimi i panairit në 11 njësitë administrative. Ato do të prezantohen me pasuritë e tyre kulturore, veshje, grupe folklorike dhe ushqim tradicional. Ky panair vlerësohet si një mundësi shumë e mirë për të promovuar vlerat kulturore, pasuritë natyrore që vendi ka, por edhe produktet e sektorit të agrobiznesit. Ky aktivitet konsiston në dy drejtime: organizimin e aktivitetit artistik të vlerave kulturore të zonave (promovimin e veshjeve tradicionale, këngë dhe valle të zonave) si dhe organizimin e panairit të produkteve të territorit (për njësitë administrative).

Bashkëpunimi me Zonën e Përmirësimit të Biznesit BID Shkodër. Përmendim këtu bashkëpunimin me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro-Amerikan) në zbatim të projektit “BID Shkodër” përgjatë rrugëve “28 Nëntori” dhe “13 Dhjetori”. Sikurse përcaktohet edhe në projekt-buxhetin e vitit 2019, zona e përmirësimit të biznesit (BID) pritet të mbështesë dhe më tepër.

Programi i Startup-eve Rinore, i zbatuar në kuadër të Projektit “Rini e Fuqizuar, e Ardhme e Qëndrueshme – Po të Ardhmes” IADSA/2016/10, u realizua me qëllim që të mbështesë ngritjen e bizneseve të reja rinore në territorin e Bashkisë Shkodër. Në program është përfshirë trajnimi i sipërmarrësve të rinj, mentorimi në materializimin e idesë së biznesit, financimi nëpërmjet skemës së granteve për idetë më të mira të biznesit, si dhe mundësi inkubimi të bizneseve startup rinore pranë Qendrës Rinore Publike “Atelie”.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile – me qëllim realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër. Në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, Bashkia Shkodër ka implementuar Programin Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet me fonde të Bashkimit Europian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i programit është të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit në BE në vendet e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet fuqizimit të shoqërisë civile duke mundësuar pjesëmarrjen e saj aktive në vendimmarrje, si dhe nxitjen dhe krijimin e një mjedisi ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile. Një ndër fushat e përparësisë së këtij programi është rinia, nëpërmjet eventeve kulturore, sportive dhe argëtuese, angazhimit në komunitet, angazhimit rinor lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe agjendën e gjelbër, si dhe zhvillimit të aftësive dhe fuqizimit ekonomik të të rinjve.

Bashkëpunim me AKPA për realizimin dhe mbikqyrjen e proceseve të integritetit në tregun e punës për të gjithë punëkërkuarit përmes ofrimit të shërbimeve të punësimit, përfshirjes në programet e nxitjes së punësimit, dhe programet e arsimit dhe formimit profesional, si dhe në adresimin sa më efektiv dhe integritetin me shërbimet e përkujdesit shoqëror, duke përfshirë programin më të madh kombëtar “Garancia Rinore”, i financuar nga Bashkimi Europian, i cili synon që çdo i ri deri në 29 vjeç, i cili nuk është në punë, arsim apo trajnim (NEET), të marrë një ofertë konkrete punësimi, formimi ose arsimit brenda 4 muajve nga regjistrimi. Programi pilotohet aktualisht në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër, në bashkëpunim me AKPA-në, bashkitë dhe partnerët ndërkombëtarë (BE, UNICEF, UNDP).

Analiza SWOT

<u>Fuqitë</u> • Hapësira të sigurt rinore (Qendra Rinore “Atelie”, Qendrat Multifunktionale, Qendrat Komunitare për Familjen) • Ofrimi i shërbimeve sociale të qëndrueshme • Turizëm i zhvilluar gjatë gjithë vitit • Traditë në arsim, kulturë dhe sport • Prania e Universitetit të Shkodrës dhe e shkollave profesionale • Shoqëri civile aktive	<u>Dobësitë</u> • Mungesa e përfaqësimit rinor në vendimmarrje • Mungesa e informacioneve të përditësuara për mundësitë në fushën e rinisë • Mungesa e financimeve të qëndrueshme për nismat rinore, start-up-et etj. • Mungesa e materialeve didaktike dhe laboratorëve kimikë/biologjikë në shkolla • Mungesa e aksesit në shërbime për të rinjtë e zonave rurale
<u>Mundësitë</u> • Pasuri natyrore dhe produkte të territorit me mundësi zhvillimi • Përmirësimi i kurikulave sipas kërkesave të tregut të punës • Krijimi i vendeve të reja të punës në sektorin e turizmit • Zhvillimi i infrastrukturës digjitale dhe digjitalizimi i proceseve të shkëmbimit të informacionit, të nevojshme për zhvillimin profesional dhe shoqëror të të rinjve	<u>Kërcënimet</u> • Shtrirje e madhe gjeografike. • Pjesëmarrje e ulët e të rinjve në vendimmarrje. • Largimi i të rinjve nga vendi. • Lëvizje demografike të theksuara dhe braktisja e zonave periferike. • Sistem i pa integruar me tregun ndërkombëtar. • Përqendrimi i popullsisë vetëm në qendrat urbane.

Rinia dhe integrimi evropian

Bashkia Shkodër e ka parë gjithnjë me interes përfshirjen e të rinjve në proceset demokratike, duke e konsideruar atë një zë të fuqishëm, të aftë për të sjellë ndryshim. E ardhmja është e rinisë, prandaj është me shumë rëndësi që të nxisim pjesëmarrjen e tyre në proceset demokratike, pjesë e së cilës, padiskutim, është edhe procesi i integritit evropian. Por, që kjo të ndodhë, duhet që të rinjve t'u japim mundësinë të shprehën dhe të mbrojnë qendrimet e tyre, të jenë aktivë në proceset vendimmarrëse.

Procesi i integritit evropian është shumë i rëndësishëm për të gjitha bashkitë në vend, i cili do të sjellë më pranë qytetarët shqiptarë dhe administratën vendore me BE-në, politikat dhe programet e saj. Ky proces përkthehet në negocimin e 35 kapitujve të Acquis-së së BE-së dhe kërkon përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë, ku një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Në 23 prej këtyre kapitujve ka një përfshirje të drejtpërdrejtë të bashkive në zbatimin e legjislacionit të Acquis-së, por ndryshon shkalla e përfshirjes nga kapitulli në kapitull. E thënë ndryshe, pas pranimi në BE, rreth 50-70% e kuadrit ligjor të BE-së duhet të zbatohet në nivel vendor; prandaj, Acquis-i i BE-së ka një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët në fushën e mjedisit, shërbimet publike, punësimi dhe përfshirja sociale, zhvillimit rural, efikasitetit të energjisë, planifikimit urban etj.

Duke e konsideruar integrimin në BE si perspektivën më të mirë të zhvillimit dhe si një sfidë të përbashkët të vendeve të rajonit, është me shumë rëndësi promovimi i bashkëpunimit të zgjeruar rajonal. Konsolidimi i këtij bashkëpunimi është i rëndësishëm së veçantë edhe në tërheqjen e fondeve të Bashkimit Evropian, në kuadër të programeve të ndryshme ndërkufitare. Një rajon që zhvillon projekte të përbashkëta në funksion të një zhvillimi ekonomik të balancuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, i shërben jo vetëm interesave vendore, por edhe procesit të integritit evropian.

Pa dyshim, një rol të rëndësishëm në këtë proces i dedikohet të rinjve dhe fuqisë së tyre për të kontribuar në krijimin e marrëdhënieve afatgjata me BE-në. Prandaj, është me shumë rëndësi që të rinjtë shkodranë të njihen me politikat rinore në procesin e integritit evropian dhe të promovojnë vlerat evropiane. Një gjë e tillë do të konsolidojë bazat e një shoqërie të hapur në rajon, e cila ofron mundësinë për të përfituar nga fondet e BE-së në fusha të ndryshme si arsimi, kultura, rinia, sporti, mjedisi etj.

Gjatë viteve të fundit, numri i programeve të financuara në kuadër të thirrjeve të IPA-së dhe programeve të tjera të financuara nga BE është i konsiderueshëm. Përmendim këtu: Programi Adrion Interreg, Horizon 2020, Programi MED, Europe Aid Call for Proposal, IPA Crossborder Shqipëri – Mali i Zi, Programi Erasmus etj.

Matrica *

Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi

Aktivitetet e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit janë një pjesë kritike për të rritur efektivitetin dhe aplikueshmërinë e planit. Ky proces është një ndër më të rëndësishmit gjatë fazës së zbatimit të një dokumenti strategjik, sepse jo vetëm parandalon devijime nga arritja e objektivave të PVVR 2023-2026, por gjithashtu ndihmon në përmirësimin e tyre. Matrica e vlerësimit dhe raportimit (gjendet në excel)

Për të siguruar një monitorim, vlerësim dhe raportim cilësor dhe të dobishëm, është e rëndësishme të definohen:

- Procesi i qartë i raportimit dhe monitorimit me përgjegjësitë dhe afatet e përcaktuara;
- Modelet dhe mjetet e caktuara që do të përdoren për monitorim;
- Kapaciteti i strukturave kryesore dhe atyre që marrin pjesë për të zbatuar procesin.

Një proces i qartë i monitorimit dhe raportimit është i nevojshëm për t'i njoftuar pjesëmarrësit mbi përgjegjësitë e tyre dhe për t'u mundësuar atyre të jenë të përgatitur për të gjitha angazhimet e tyre, duke u bazuar në një kalendar të caktuar më parë. Sistemi i monitorimit duhet të jetë i organizuar mirë për të ndjekur të gjitha fazat e projektit dhe për të përcaktuar dhe konfirmuar strukturat monitoruese.

Modelet dhe instrumentet janë të nevojshme për rrjetin e komunikimit mes strukturave dhe për të garantuar se paraqitja e informacionit është e pajtueshme dhe e lehtë për t'u konsoliduar. Udhëzimet se si të plotësohen modelet duhet të jenë të përgatitura në mënyrë të tillë që të jenë të lexueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Përveç modeleve për elementë si objektivat, do të jenë të nevojshme edhe sqarimet, sidomos në rastet kur vërehen vonesa apo mangësi, për të detajuar elementët që sjellin devijime serioze. Informacioni i prodhuar përmes sistemeve të monitorimit dhe raportimit mund të përdoret brenda Bashkisë për të marrë vendime dhe jashtë saj për të siguruar transparencë për publikun e gjerë.

Kapaciteti i strukturave për të prodhuar informacion cilësor dhe për të konsoliduar informacionin është shumë i rëndësishëm. Duhet përpjekje dhe aftësi për të prodhuar informacion raportimi të mirë, të bazuar në analiza dhe të mbështetur nga prova. Praktika në sektorin publik tregon se shumë shpesh raportimi i informacionit fokusohet më shumë në veprimet e përditshme rutinore sesa në analizën e arritjeve. Kapaciteti mund të përmirësohet përmes udhëzimeve, trajnimit dhe praktikës.

Sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit i propozuar përbëhet nga dy nivele:

- Niveli i parë lidhet me monitorimin e projekteve, duke ndjekur me vëmendje arritjen e indikatorëve të përcaktuar në këtë dokument. Ky proces do të realizohet nga strukturat përgjegjëse brenda dhe në varësi të BSH. Raportet e monitorimit të këtyre strukturave do të dërgohen tek struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe jetësimin e prioriteteve në BSH. Periodiciteti i monitorimit është vendosur bazuar në specifikat që ka çdo projekt

- Niveli i dytë lidhet me vlerësimin e përmbushjes së objektivave dhe rezultateve të pritshme. Ky vlerësim do të realizohet çdo fundviti, ku nëpërmjet analizës së raporteve të monitorimit do të vlerësohet masa e përmbushjes së objektivave, krahasimi i masës së arritjeve me masën e parashikuar, si edhe, në raste të veçanta, do të propozohen edhe ndryshime në projekte, kohëzgjatje, afate, fonde etj.

Monitorimi dhe vlerësimi i PVVR-së është një fazë shumë e rëndësishme dhe matësi më i mirë i suksesit në zbatueshmërinë e saj. Puna do të nisë bazuar në procedurat administrative për të siguruar raporte mbi zbatimin e projekteve të ndryshme. Pastaj, gradualisht do të përmirësohet cilësia e informacionit të krijuar gjatë procesit dhe, përfundimisht, ky informacion do të përdoret në sistemin e vendimmarrjes.

Bazuar në kalendarin e monitorimit të strategjisë, çdo vit do të përgatiten vlerësimet e ecurisë së PVVR-së dhe do të raportohet tek Kryetari lidhur me ecurinë e punës për përmbushjen e objektivave strategjike. Në varësi të ecurisë së punës, mund të propozohen edhe rishikime të objektivave strategjike. Në varësi të specifikave të monitorimit/raportimit të projekteve, ky proces do të kryhet në periudha 3 – 6 mujore. Raportet do t'i dërgohen strukturës përgjegjëse sipas afateve të përcaktuara. Vëmendje të veçantë i është kushtuar indikatorëve si sinjalizues të ecurisë së punës.